

**FEDERATA E KARATESË E KOSOVËS**

**KOSOVA KARATE FEDERATION**



**RREGULLORE  
PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM TË FKK-së**

Prishtinë, 2021

Në bazë të nenit 13 të Statutit të Federatës së Karatesë të Kosovës, Bordi i Federatës së Karatesë të Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 19 qershor 2021, miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN E BRENDSHËM TË FKK-së**

### **I. DISPOZITAT FILLESTARE**

#### **Neni 1**

Me këtë Rregullore përcaktohet organizimi i brendshëm i Federatës së Karatesë të Kosovës në pajtim me Statutin e FKK-së.

### **II. ORGANIZIMI I BRENDSHËM**

#### **Neni 2**

1. Federata e Karatesë e Kosovës është Federatë sportive e klubeve të karatesë të Kosovës të bashkuara vullnetarisht dhe mbi baza të barabarësisë, me qëllim të zhvillimit dhe avancimit të sistemit të garimit, të organizimit të punës dhe të arsimit si të sportistëve, ashtu edhe të trajnerëve dhe gjyqtarëve në sportin e karatesë.
2. Me qëllim të rregullimit të obligimeve të përcaktuara me Statut, Federata e Karatesë e Kosovës punën e vet e ka të organizuar nëpërmjet organeve dhe komisioneve të Federatës së Karatesë të Kosovës.

### **III. ORGANET QEVERISESE DHE MENAXHUESE TË FEDERATËS SË KARATESË TË KOSOVËS**

**Organet qeverisëse të Federatës së Karatesë së Kosovës janë:**

#### **Neni 3**

1. Kuvendi i Federatës së Karatesë të Kosovës,
2. Bordi Ekzekutiv i Federatës së Karatesë të Kosovës.

#### **Neni 4**

Organet menxhuese të FKK-së janë:

- 4.1 Kryetari i FKK-së
- 4.2 Sekretari Përgjithshëm i FKK-së
- 4.3 Administrata e FKK-së

## **Neni 5**

1. Komisionet profesionale të Federatës së Karatesë të Kosovës janë:

- 5.1 Komisioni për Çështje Juridike
- 5.2 Komisioni i Garave
- 5.3 Komisioni i Gjyqtarëve
- 5.4 Komisioni Mjekësor dhe Antidoping
- 5.6 Komisioni i Gradave
- 5.7 Komisioni Disiplinor
- 5.8 Komisioni për Zgjedhjen e Sportistit të Vitit
- 5.9 Komisioni për Media dhe Marrëdhënie me Publikun
- 5.10 Komisioni për Para-Karate
- 5.11 Komisioni për Trajner dhe ngritje profesionale

2. Funksionimi i komisioneve profesionale është i rregulluar me Rregullore të Komisioneve përkatëse.

## **Neni 6**

1. Komisionet Profesionale të Federatës së Karatesë të Kosovës funksionojnë në baza profesionale të anëtarëve të zgjedhur legalisht nga mesi i përfaqësuesve të klubeve të karatesë, anëtare ose njerëz profesional të propozuar nga Federata e Karatesë së Kosovës.

2. Për punën e tyre në organet dhe komisionet profesionale të FKK-së anëtarët e tyre kompensohen sipas vendimit të Bordit Ekzekutiv të FKK-së për pagesën e Kryesueseve dhe anëtarëve të Komisioneve Profesionale.

## **IV. ADMINISTRATA E FKK-së**

### **Neni 7**

#### **Zyrtarët administrativë të FKK-së**

1. Në përputhje me nenin 8 të Statutit, në rast nevoje Bordi Ekzekutiv i Federatës së Karatesë të Kosovës do të hapë vende pune ose të emërojë zyrtarë.

2. Sekretari i Përgjithshëm i analizon dhe i arsyeton kërkesat për nevojat e stafit administrativ tek Bordi Ekzekutiv i FKK-së.

3. Bordi Ekzekutiv i FKK-së autorizon sekretarin e përgjithshëm për hapjen e konkursit për punëtorë të ri me kontrata të rregullta të punës sipas ligjit për shërbyesit civil.

4. Kohëzgjatja e punësimit të punëtorëve është përcaktuar me kontrata të rregullta të punës ku specifikohen detyrat dhe përgjegjësitë e tyre sipas ligjit për shërbyesit civil të Kosovës.

### **Neni 8**

#### **Zyrtarët me marrëveshje të angazhuar në FKK**

1. Zyrtarët do të angazhohen përmes marrëveshjes së shkruar, e cila do të detajizojë të gjitha të ardhurat dhe të mirat e tjera që duhet t'i paguhet zyrtarit të angazhuar.

2. Të gjitha pagesat duhet të jenë të arsyeshme dhe duhet të paguhen vetëm për punën e kryer për Federatën e Karatesë së Kosovës.

## **V. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 9**

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen në mënyrë dhe me procedurë të njëjtë sikur aprovimi i saj.

### **Neni 10**


Bashkangjitur kësaj rregullorëje gjeni si shtojcë SKEMËN organizative të FKK-së.

### **Neni 11**

Kjo rregullore hyn në fuqi pas aprovimit nga Bordi Ekzekutiv i FKK-së dhe nënshkrimi i kryetarit të FKK-së

Prishtinë, 19 Qershor 2021

Ismet Krasniqi

  
Kryetar